



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË PESTË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Mbledhja është mbajtur më 23.05.2017 (e Martë) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira, nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu; këshilltarët e Kuvendit: Sami Demelezi, Zekrija Zuka, Nexhat Aliu, Xhilsime Qamili, Ali Bajrami, Adnan Imeri, Vjollca Kadolli - Halili, Nuredin Lutfiu, Ajtene Frangu, Arbëresha Ibrahim Bekim Azizi, Samet Idrizi, Taib Alidema, Hyse Rama, Visar Demiri, Sejdi Emini, Bislim Bislimaj, Daut Xhemajli, Vjollca Sylejmani, Ekrem Abazi, Mirlinda Sadiku, Vehbi Rama, Majlinda Ostrogllava, Besjana Rexhepi, ndërsa në mbledhje mungoj, Baki Nebiu. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësuesja e Zyrës Ligjore, përfaqësuesi i Zyrës për Integritim Evropian, mjetet elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 26 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e pestë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Më lejoni të përshëndes, nënkryetarin e Komunës, z.Hasan Aliu, juve të respektuar Këshilltar komunal, drejtorë të drejtorive të cilët janë prezent në këtë seancë, përfaqësuesit e OSBE-së, mediat e shkruara dhe të gjithë të tjerët që janë prezent. Më lejoni të ju informoj, se Zyra Ligjore e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, na ka konfirmu ligjshmërinë e disa akteve që janë miratuar nga Kuvendi. Para se të kalojmë te miratimi i rendit të ditës, nëse ka dikush të parashtroj pyetje ose propozime, fjala është për ju, urdhëroni.

z.Adnan Imeri: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Me datën 19.05.2017 ja kam dorëzuar njoftimin kryesuesit të Kuvendit, se nuk jam më pjesë e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe strukturave të saj. Tani e tutje funksionin e këshilltarit të Kuvendit Komunal do ta ushtroj si këshilltar i pavarur. Besoj shumë, se do ta jap kontributin tim edhe si këshilltar i pavarur, mendoj që kemi një shtet demokratik, jemi shoqëri demokratike dhe çdo person ka të drejtë të zgjidhet, ka të drejtë të zgjedh. Unë mendova, se ashtu e besoj, që e kam marr një vendim të duhur.

znj.Mirlinda Sadiku: Përshëndetje për të gjithë! Këtu dua ta prezantoj kanalën, të cilin e kam ngritur para dy tri seancave. Te “Lagjja Zejnullahu” në Skifteraj, po ashtu kam pyetje për drejtorin e Arsimit. Para disa muajve drejtori i shkollës “Junuz Zejnullahu” pat paraqitur një rregullore për mësimin jo formal: Çka ndodhi, ma nuk erdh kjo rregullore? Pyetje për qeverisjen komunale: A ka kapacitet Komuna e Vitisë, që punët t’i kryej nga dy herë? Ky është trotuari në fshatin Skifteraj, i cili është aprovu nga qeverisja e kaluar, është implementu nga qeverisja e juaj në vitin 2014. Në vitin 2015 e dini qysh është harru asfalti i Tërpezës, ky është asfalti i cili është asfaltu në fund të vitit 2016. Siç shifet në foto, njëjtë e kemi edhe rrugën “Kemajl Azizi”, prandaj bëj pyetje: A duhet t’i bëjmë të njëjtën punë nga dy herë? Ndërsa për drejtorin për Shërbime Publike, është shumë e rëndësishme, që në fshatin Radivojc nuk ka ndriçim publik. Aty gjendet shkolla dhe ajo rrugë është kjo shumë e qarkullime, është e domosdoshme që aty të ketë ndriçim publik.

z.Bekim Azizi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Për drejtorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Me sa e di unë, para nja dy javë diçka në podrum të Shtëpia e Kulturës është kall: Çka ka qenë ai zjarr, kush e ka shkaktuar atë zjarr, pse nuk është bërë një sqarim për këtë? E kemi pas edhe një vjedhje të çerdhja, çfarë vjedhje ka qenë, çka ka ndodh, edhe këtu një sqarim.

z.Nuredin Lutfiu: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Kam një pyetje nga banoret e fshatit Skifteraj lidhur me kontratën me Luxemburgun, lidhur me ujësjellësin, ku janë përfshi 5 fshatra, dhe Skifteraj është në marrëveshje, duam ta dimë deri ku kanë shku procedurat rreth rehabilitimit të ujësjellësit në Skifteraj.

Drejtori z.Qahil Sinani: Përshëndetje për të gjithë! Për rregulloren që pyeti asamblistja, duhet të përpunohet ende në këtë rregullore, se janë disa gabime që nuk po përshtaten me realitetin, ndërsa të çerdhja kanë qenë dy herë vjedhje, edhe ato janë bërë përshkak të ushqimit. Herën e parë sun e kanë gjetë ushqimin që përgatitet për fëmijë, pra herën e dytë kanë hi për dritare edhe janë zan, ata janë fëmijë adoleshent. Tash janë në dorë të policisë dhe të gjykatave.

Nënkryetari z.Hasan Alia: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Edhe unë e konsideroj veprim demokratik lëvizjen e këshilltarëve. Unë i uroj shëndet e suksese këshilltarit. Pyetjet rreth kanalit të “Lagjja Zejnullahu”, duhet me këshyr mundësitë buxhetore të cilat i kemi. Ne kemi vepruar atje, e dimë vendin, i kemi qel dy kanalle atje po edhe të kjo lagje, i di problemet, por po presim mundësitë buxhetore. Ne duhet të bisedojmë për çështjet për të cilat i kemi miratuar buxhetin dhe duhet me ditë a jam duke i realizuar ato për të cilat i kemi miratuar buxhetin. Për çështjen e asfaltit në Tërpezë kemi fol, po prapë po thamë, na si qeveri me shumë kemi bërë përpjekje atje për mu përmirësu edhe u përmirësu aq sa ka pas mundësi, se sa ju që e kemi ngritur si çështje këtë. Çështja e trotuarit, ne e kemi ndreq, por nuk do me thanë që nuk mundet mu prish, me luftë kockat nëse dikush hynë me kamjan, duhet të thomi realisht qysh janë. Edhe të rruga “Kemajl Azizi” është ashtu, po përpjekjet janë të vazhdueshme për mu rregullu. Në Radivojc për ndriçimin publik, po ne jemi në vendin e parë që i kemi kushtuar rëndësi ndriçimit publik, por duhet me i pa mundësitë. Zjarri në Shtëpinë e Kulturës e vërtet ka ndodhë, por fal rojës të cilët e kanë vërejt zjarrin dhe kanë interevnu, ka ndodhë në podrum, po janë kap kryesit, janë të mitur. Kjo ka ndodhë kur shoqëria “Kemajl Azizi” ju ka dhënë çelësi për me ushtruar, e ku kanë deportu do fëmijë dhe e kanë keqpërdor, por fal rojës ka interevnu me kohë, e ku nga policia është zbulu rasti e janë identifikuar

fëmijët të cilët kane qenë kryes. Ndërsa te ujësjellësi ne Skifteraj, është faza e pestë, çështja nuk varet krejt prej Komunës, por jem në bashkëpunim e po shkojmë pak me kadale.

znj. Mirlinda Sadiku: Nënkrjetar, kjo është krejt në anën tjetër të udhës, nuk është shkakty ky dëm prej automjeteve. Unë e bëna pyetje, se a ka mundësi buxhetore komuna që te njëjtën punë me bë ka dy tri here, në vend se me investu dikun tjetër po duhet me investu me riparuar qatë punë që nuk u kry, e kur të ja shtojmë kësaj edhe pasqyrat financiare, kur na u kanë pru, që komuna ka kontraktu kompani në vlerë dikun 25 mijë euro për mbikëqyrjen e projekteve, po ashtu komuna e ka edhe zyrën e mbikëqyrjes së projekteve, atëherë pse po ndodhin këto gabime. Me pas ndodh një aksident kur ka ra kulmi i shkollës në fshatin Skifteraj, aty do të kishte pasoja edhe në fëmijë. Unë krejt çka po kërkoj është të shtohet mbikëqyrja, të behet presion ne zyrën e mbikëqyrjes së projekteve po ashtu dhe të operatorët ekonomik, që mos të ndodhin raste të tilla.

Drejtori z.Nexhmedin Jakupi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Ne si drejtori e kemi pas informatën, se ajo rruga në Radivojcë në 2017 do të zgjerohet, e për këtë nuk kemi muajt me planifiku për ndriçimin publik edhe pse e di që ka nevojë, por duke pasur parasysht zgjerimin e rrugës nuk e kemi planifiku ndriçimin edhe në brendësi të fshatit nuk e kemi bë ndriçimin publik pasi që kemi pas biseda me KEDS-sin e ku na kanë dhanë premtime, se do t'i ndërrojnë shtyllat e vjetra, kjo është arsyeja.

Kryesuesi z.Naim Pira: I falënderoj të gjithë, pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, për mbledhjen e pestë të Kuvendit Komunal kemi parapare këtë:

R e n d i t e

- 1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e katër e KK-së të Vitisë.**
- 2. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e rishikimit të buxhetit për vitin 2017.**
- 3. Informatë mbi Festivalin e "Flakadanit të Karadakut".**
- 4. Informatë mbi përgatitjen për mirëmbajtjen e rrugëve në sezonin veror.**
- 5. Informatë mbi punën e komiteteve funksionale.**

A ka dikush rreth rendit të ditës? Kush është që te miratohet ky rendi i ditës me këto pika? Nga te gjithë te pranishmit u miratua rendi i ditës.

Pika e parë

- 1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e katërt e Kuvendit Komunal të Vitisë**

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat rrethe procesverbalit: A ka dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim? E hedh në votim procesverbalin, me votat e të gjithëve u miratua procesverbali.

Pika e dytë

- 2. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e rishikimit të buxhetit për vitin 2017**

Drejtori z.Ibrahim Rama: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Duke u bazuar në ligjet e aplikuara në Republikën e Kosovës, para juve e kemi paraqit këtë propozim vendim, ku kryetari i komunës në konsultim me drejtorit përkatëse ka të drejte gjate vitit fiskal bazë ligjeve me e rishiku buxhetin sipas nevojave të qeveris komunale. Propozim vendimin e keni pranuar me kohë, për pyetje dhe sqarime urdhëroni.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat për këtë pikë të rendit të ditës.

znj. Vjollca Kadolli-Halili: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! I dëgjuam sqarimet e drejtorit. Ne si grup parlamentar jemi për këtë propozim vendim.

z.Samet Idrizi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, normal që kemi të drejt me bë rishiqime të tilla po me ra ne sy se vlera nuk është madhe po ndryshimi kaq i madhe i kaq shume zërave ose e pasqyron nje planifikim jo të mire ose ka nje doment tjetër po si do që te jet ne do ta votojm.

z.Daut Xhemajli: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë në rishqyrtim të buxhetit kam prit që udhëheqja e komunës të insistoj në Qeverinë e Kosovës, që me rishqyrtimin e buxhetit të përfshihet kyqja e Vitisë në autostradë, ngase Qeveria e Kosovës ka thanë që nuk kemi mjete e ku pa rishqyrtim të buxhetit nuk bëhet ajo, dhe në këtë segment unë kërkoj që nga komuna jonë të insistohet, që në rishqyrtim të buxhetit në këtë vit të përfshihet edhe kyqja e Vitisë në autostradë në Gerlicë, ku nga buxheti i komunës sonë të participohet në at kyqje, të shprehet disponimi jon, ngase të gjithë ne asamblistët kemi kërkuar kyqjen në autostradë në Gerlicë.

z.Ibrahim Rama: Rishikimi i buxhetit është i paraparë me ligj në këtë vit, është viti i parë që zbatohet ligji në përpikëri. Me këtë propozim vendim pjesa dërmuese janë në kategorinë për shërbime dhe mallra, kurse te investimet kapitale mirë i kemi pas planifiku dhe te pagat është mirë po kjo tabel është kryesisht me shifra të vogla. Sa i përket kërkesës se Dautit për vitin 2017 nuk guxon me pas ndryshim prej një projekti me kriju projekt të ri deri sa nuk ka një donacion tjetër për me plotësu at projekt që e eliminon, por edhe duhet me ditë që Komuna e Vitisë nuk ka të drejtë ligjore me financu në projektet që janë jashtë territorit administrativ të Komunës së Vitisë, po kjo administratë është projekt kombëtar që kalon në shumë komuna, por që nuk e prek Komunën e Vitisë, por kjo kyqje besoj që do të ndodh me vendim të Qeverisë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka të tjerë e qes në votim: Kush është që te miratohet kjo pikë e rendi të ditës? Konstatohet se me votat e të gjithëve u miratua kjo pikë e rendi të ditës.

Si pikë të tertë të rendit të ditës kemi:

3. Informatë mbi Festivalin e "Flakadanit të Karadakut"

Zyrtari i drejtorisë së kulturës z. Ismet Sejdiu: Përshëndetje për të gjithë të pranishëm! Drejtori i sapo ardhur me ka autorizuar, që unë të bëjë këtë informatë rreth kësaj ngjarje. Ne në fillim kemi bë këshillin e organizimit, ku kanë qenë 21 anëtar, duke filluar nga Kryetari i Komunës duke e përfshi faktorët të ndryshëm si polici, artistik etj. Ne si staf kemi bë edhe trupën koordinuese të manifestimit e ku i kemi nda detyrat veç e veç. Manifestimi Flakadani i Karadakut 2017 ka qenë edicioni i 16 me radh, si një nga ngjarjet me të mëdha kulturore në Komunë të Vitisë, ku tubon artistët dhe grupet artistike të mbar kombit shqiptar e me gjerë. Materialin e keni pranuar me kohë, për pyetjet dhe përgjigje jam në dispozicion e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat rreth kësaj pikë.

Si pikë të katërt e rendit të ditës kemi:

4. Informatë mbi përgatitjen për mirëmbajtjen e rrugëve në sezonin veror

Drejtori z.Nexhmedin Jakupi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Për mirëmbajtjen e rrugëve për sezonin dimërorë dhe veror, Komuna e Vitisë çdo vit shpall tender për përzgjedhjen e kompanisë e cila konkurren me çmim më të mirë edhe këtë viti për 2017-2018 është e përzgjedhur kompania "Zuka Komerc", vlere e kësaj kontrate është 68,271.50€. Ne kemi kërku nga kompania që të bënë përgatitjen e nevojshme për mirëmbajtjen e rrugëve verore. Kompania është zotu se do të bënë mirëmbajtjen e rrugëve. Ne tani vetëm kemi fillu me sanimin e rrugëve të cilat i kemi

vlerësu se kanë qenë mjaft të dëmtuara. Materialin e keni pranuar me kohë, për pyetje dhe përgjigje jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat për këtë pikë të rendit të ditës, pasi që nuk ka për debat

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

5. Informatë mbi punën e komiteteve funksionale.

Ju e dini se Kuvendi e ka themeluar edhe komitetet të cilët janë obligative dhe komitetet jo obligative. Unë muj me than se komitetet obligative siç janë KPF dhe Komiteti për Komunitete kanë qenë aktive duke i organizuar mbajtjen e seancave të tyre. KPF ka mbajtur aq mbledhje sa ka mbajtur edhe Kuvendi, ndërsa Komiteti për Komunitete ka mbajtur pesë mbledhje vitin e kaluar, ndërsa komitetet jo aktive nuk janë funksionale me përjashtim të Komitetit për Shëndetësi ka mbajtur disa takime, ndërsa të tjerët jo, për faktin se nuk paguhet. Por unë po i inkurajoj ato që të mbajtur takime, sepse janë në të mirën e Kuvendit. Edhe me rëndësi të ju njoftoj, se unë para dy jave isha në takim që e kishte organizu MAPL-ja lidhur me raportin e funksionimit të komunave dhe mund të ju them, se jemi ndër komunat e vetme të cilët nuk kemi asnjë shkelje. Materialin e keni pranuar me kohë, për pyetje dhe përgjigje urdhëroni.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debatin rreth kësaj pike të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për diskutim, ju faleminderit të gjithëve për kontributin e dhënë.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 10:50 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Naim Pira
